



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** dhe nenit 17, paragrafi 17.1 pika **h** të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 15 të Udhëzimit administrativ nr. 04/2018, për transparencë në komuna, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr.01-110-391, të dt. 25.02.2010, në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2019 merr këtë

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË

I.

MIRATOHET Vendimi për Planin e veprimit katër (4) vjeçar për transparencë në Komunën e Prishtinës.

II.

Plani i veprimit për transparencë, i cekur në nenin I të këtij vendimi, është bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 04/2018, për transparencë në komuna dhe legjislacionin tjetër në fuqi, i cili përmban 24 objektiva.

III.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është kopja e Planit të veprimit katër (4) vjeçar për transparencë në Komunën e Prishtinës.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Administratës.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pune pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-0073665/19, më 29.03.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

